



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE
SPORTIT**



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe
Inovacionit/Ministarstvo Obrazovanja,
Nauke, Tehnologji e Inovacije/ Ministry of
Education, Science, Technology and Innovation

Nr. 7497 Prot., datë 03.12.2024

Nr. 242 Prot., datë 19.12.2024

URDHËR/VENDIM I PËRBASHKËT

NR. 2, DATË 03.12.2024

PËR

**REALIZIMIN E OLIMPIADËS SË PËRBASHKËT TË GJUHËS SHQIPE KLASA 9-
TË, PËR VITIN SHKOLLOR 2024-2025**

Në mbështetje të shkronjës “d”, të pikës 3, të nenit 3 të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës për realizimin e olimpiadës së përbashkët në lëndën “Gjuhë shqipe”, klasa e 9-të, arsimit i mesëm i ulët parauniversitar, datë 05.07.2023, Urdhrit/vendimit të përbashkët nr.1, datë 02.12.2024 “Për miratimin e akteve rregullatorë në zbatim të marrëveshjes “Për realizimin e olimpiadës së përbashkët në lëndën “Gjuhë shqipe”, klasa e 9-të, arsimit i mesëm i ulët parauniversitar”.

URDHËROJ/VENDOS:

- Miratimin e datës, orës dhe vendit të zhvillimit të secilës fazë të olimpiadës së përbashkët të gjuhës shqipe, për klasat e 9-ta si më poshtë:
 - Faza I-rë, 11 mars 2025, ora 9.00-11.00. Realizohet në nivel shkolle në mjediset e shkollës.
 - Faza II-të, 20 mars 2025, ora 10.00-12.00. Realizohet në nivel ZVAP/DKA, në mjediset e caktuara prej tyre.
 - Faza III-të, 27 mars 2025, ora 10.00-12.00. Realizohet në nivel shteti dhe organizohet në mjediset e caktuara nga MAS/MASHTI.
 - Faza IV, 10 prill 2025, ora 10.00-12.00. Realizohet në Tiranë, në nivel ndërshtetëror, në mjedisin e caktuar nga MAS.
- Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri/vendimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Agjencia Kombëtare e Arsimit

Parauniversitar, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar/Drejtoritë Komunale të Arsimit, institucionet arsimore parauniversitare (shkollat) dhe grupet respektive të punës.

Ky urdhër/vendim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Ogerta MANASTIRLIU



MINISTËR

Arbërie NAGAVCI

